



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLARI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT
PËR VITIN 2022**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njojur Entin Rregulator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke vlerësuar se viti 2022 ishte viti i fillimit të një reforme rrënjosore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetencë të Përbashkëta (SKP), të regjistruara si shoqëri UK Rajonale, ndërkohë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit;

Duke vlerësuar se objektivi kryesor i procesit të reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK;

Duke vlerësuar se saktësia e të dhënavë të raportuara mbetet sfidë për shoqëritë UK, pasi ato janë elementi bazë i një analize objektive të performancës së shoqërive, si dhe përvendosjen e objektivave nga ERRU-ja për përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen;

Duke vlerësuar faktin se gjendja e sektorit UK për vitin 2022, e paraqitur përmes Treguesve Kryesore të Performancës, krahasuar me vitin e mëparshëm tregon një performancë të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit, me përfashtim të treguesit finanziar "Mbulimi i kostove O&M";

Duke vlerësuar faktin se kriza globale e energjisë elektrike pati një ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e treguesit "Mbulimi i kostove O&M".

Vlerëson për vitin 2022:

Fillimin e një reforme rrënjosore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetencë të Përbashkëta (SKP), të

regjistruara si shoqëri UK Rajonale, ndërkokë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Reforma ka si objektiv kryesor që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Përmirësimin e lehtë e pothuajse të të gjithë Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, me përjashtim të treguesit “Mbulimi i kostove O&M”.

Punën e bërë nga ERRU-ja në drejtëm të mbrojtjes së konsumatorëve, ku, përvèç zgjidhjes së ankesave ndërmjet konsumatorëve dhe shoqërive UK, është krijuar dhe funksionon tashmë edhe pranimi online i ankesave të konsumatorëve nëpërmjet faqes se re zyrtare të ERRU-së, www.ERRU.al.

Rolin proaktiv që ka luajtur ERRU-ja në kuadër të reformës duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtëm të licencave dhe tarifave, të cilat i shërbejnë përspejtimit dhe ecurisë së reformës, duke u dhënë shoqërive UK të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në SKP, si dhe duke i lejuar shoqëritë SKP-UK të përdorin tarifat aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU-ja deri në miratimin e tarifave të reja.

Shtimin e dy treguesve të rinj të performancës në vlerësimin e shoqërive UK, përkatësisht “Ankesat e klientëve” dhe “Efiçenca e energjisë”. Treguesi i parë lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe në mbrojtje të interesave të tyre, ndërkokë që treguesi i dytë, “Efiçenca e energjisë”, merr një vëmendje të veçantë në përgjigje të krizës globale të energjisë elektrike.

Punën e bërë nga ERRU-ja në miratimin e licencave për 17 shoqëri UK, nga të cilat 15 shoqëri UK (shoqëritë ekzistuese) dhe 2 shoqëri UK Rajonale të krijuara sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022.

Punën e bërë nga ERRU-ja me rritjen e numrit të monitorimeve të zhvilluara në 26 shoqëri UK, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës së shoqërive UK dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet katër rregullatorëve të sektorit të ujërave në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht: Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni, duke rritur nivelin e bashkëpunimit rajonal në adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, shkëmbimin e eksperiencave pozitive, si dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së në këtë fushë.

Përmirësimin me afro një orë krahasuar me vitin 2021 (duke arritur nivelin 16.3 orë/ditë) të treguesit “Kohëzgjatja e furnizimit me ujë”, e cila shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e kryera në sektor, ku rritja e orëve të furnizimit me ujë 24/7 është edhe objektiv në planin afatshkurtër 2018-2023.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 rekomanodon:

- ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjosore në sektorin UK, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri, të ketë prioritet në punën e saj bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për të bërë të mundur zbatimin me sukses të kësaj reforme të rendësishme.

- ERRU-ja në kuadër të reformës në sektorin UK, të marrë masat e nevojshme për t'i përgjigjur në kohë pajisjes me licencë të SKP-ve të reja (Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta), të krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, në përputhje me kategorinë përkatëse të shërbimit të ofruar dhe rishikimin e tarifave ekzistuese.

- ERRU-ja, duke qenë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas urdhrit nr. 165, datë 8.9.2022 “Për hartimin e strategjisë

sektorale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri”, të ndikojë në rishikimin e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregulator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, duke pasur parasysh forcimin e rolit të rregulatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.

4. Në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në, të kontribuojë dhe të jetë pjesë aktive e grupeve të punës lidhur me kërkeshat që Shqipëria duhet të përmbushë në lidhje me Direktivat Europiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN .

5. ERRU-ja, gjatë monitorimeve të shoqërive UK në terren, si dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave, t'i kushtojë vëmendje të veçantë rritjes së eficiencës së energjisë përmes përdorimit të burimeve alternative të rinovueshme nga shoqëritë UK, si një nga sfidat kryesore për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive në kushtet kur rritja e çmimit të energjisë elektrike ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e treguesit “Mbulimi i kostove të O&M”.

6. Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK për procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime për t'u realizuar nga ata.

7. ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjosore në sektorin e ujit në Shqipëri, duhet të bashkëpunojë me institucionet kryesore, në mënyrë që të ketë një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë UK, duke i parë ato të lidhura me përmbushjen e objektivave të caktuara nga ERRU-ja dhe duke shërbyer si element nxitës për shoqëritë për përmirësimin e treguesit të ujit pa të ardhura dhe treguesve të tjera të performancës. Në të njëjtën kohë ERRU-ja, gjatë procesit të aplikimit për nivel të ri tarifor nga shoqëritë UK, të kërkojë vendosjen e objektivave konkretë nga shoqëritë UK në reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike si për lidhjet e paligjshme, nën faturime, ashtu edhe për abuzimet e ndryshme për ujitje etj.

8. ERRU-ja në kuadër të reformës, të vijojë të luajë një rol proaktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme, si dhe duke zhvilluar takime me drejtuesit e rindërtimit të shoqërive UK Rajonale të krijuara, me qëllim diskutimin e pengesave të ndryshme që hasen për zbatimin e reformës gjatë periudhës tranzitore, si dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregulator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

9. ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjosore në sektorin e ujit në Shqipëri, të ketë në fokus kryesor të vëmendjes reduktimin e stafit të tepërt të shoqërive UK rajonale kur këto do të aplikojnë për tarifa të reja pranë saj, si dhe të monitorojë dhe rekomandojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve që ndikojnë në shpenzime.

10. Me hyrjen në fuqi të reformës, ERRU-ja të bashkëpunojë me institucionet përkatëse duke vlerësuar nevojat dhe fondet e nevojshme për realizimin e monitorimeve dhe të sigurisë së veprave të sistemeve të furnizimit me ujë dhe KUN, dhe njëkohësisht të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e legjislacionit për të vendosur në baza konkrete dhe me kosto të arsyeshme garantimin e sigurisë së objekteve me karakter strategjik të sistemeve të furnizimit me ujë.

11. ERRU-ja të kryejë një analizë lidhur me strategjinë dhe mundësinë e tarifave që duhet të propozojnë për miratim shoqëritë e reja rajonale pranë ERRU-së me synim dhe prioritet që ato të janë të unifikuara për secilën shoqëri UK Rajonale. Kjo analizë të shoqërohet me konkluzione dhe rekomandime për realizimin konkret të strategjisë së mundësisë së unifikimit të tarifave me fokus përmirësimin e performancës së sektorit UK.

Miratuar në datën 30.3.2023